



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

**Nr. i Dokumentit: 21.4.1-2014-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT FINANCIARE TË UNIVERSITETIT TË**  
**PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA" PËR VITIN E PËRFUNDUAR**  
**MË 31 DHJETOR 2014**

**Prishtinë, qershor 2015**

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm në Detyrë është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe çertifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm në Detyrë ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Bujar Bajraktari i mbështetur nga, Kapllan Muhaxheri (Udhëheqës Ekipi), Shefkije Beka-Gërvalla, Fjolla Bakalli-Sadiku dhe Krenare Pirana-Kiseri.

## TABELA E PËRMBAJTJES


Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia .....	7
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	9
3 Rekomandimet e vitit paraprak.....	12
4 Qeverisja e përgjithshme .....	13
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP .....	30
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak .....	32

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave financiare vjetore për vitin 2014 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Unë do të doja të falënderoja Rektorin e UP-së dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2014 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA) të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 07 Nëntor 2014.



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2014 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

### Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.


Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Si *Theksim i çështjes* në dëshirojm të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se shpalosjet e pasurive fikse nuk janë plotësisht të besueshme. Kjo nuk ka ndikim në ndonjërin prej dy Pasqyrave Financiare (“Pranimet dhe Pagesat në Para të Gatshme” dhe “Krahasimi i Buxhetit me Shumat Aktuale”), në pajtim me SNKSP në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme. (**SNISA 200/1706 Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes**).

## Konkluzioni i përgjithshëm

Bazuar në detajet e paraqitura në secilën pjesë të këtij draft raporti, konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore dretjuar Rektorit janë:





#### Përgjigja e Menaxhmentit – auditimi 2014

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha të gjeturat dhe konkluzionet e auditimit dhe janë zotuar se do ti adresojnë rekomandimet tona.

## 1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e të përgatis pasqyrat vjetore financiare Universitetit të Prishtinës (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinioneve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale për të përcaktuar shkallen deri ku mund të mbështetemi në to, për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmimeve, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP). Aktivitetet e menaxhmentit përcaktojnë edhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë dhe auditimit të qeverisjes së mirë të cilat nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në opinion.

Qasja jonë audituese ndaj qeverisjes fokusohet në vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti me qëllimin për të siguruar menaxhim efektiv financiar dhe kontroll, si dhe në vlerësimin e rezultateve të këtyre veprimeve në dhënien efikase të outputeve cilësore operacionale. Kjo, për shembull, mund të jetë një aktivitet monitorimi i ndërmarrë nga menaxhmenti ose nga nivele më të ulëta të kontrolleve operacionale. Ne konsiderojmë nëse kontrollet janë të dizajnuara mirë, nëse janë implementuar sipas planit dhe nëse operojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, përfshirë këtu edhe rolin e Auditimit të Brendshëm dhe të Komitetit të Auditimit si dhe kontrollet e brendshme të sistemit.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti i ka adresuar rekomandimet e bëra në vitin 2013 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Në fazën e auditimit të ndërmjetëm ne ofrojmë këshilla me qëllim që të mundësojmë ndërmarrjen e veprimeve përkatëse para prodhimit të PVF-ve dhe para auditimit final.

Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** – Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do të raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe teste substanciale të shoqëruara me to vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithë-përfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

## 2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

### Përshkrimi

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

### Konkluzioni i përgjithshëm

UP nuk i ka adresuar gabimet sa i përket shpalesjes së pasurive dhe obligimeve të pa paguara në PVF. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, të cilës i jemi referuar më lartë, nuk ishte e saktë në të gjitha aspektet. Pavarësisht kësaj, cilësia e PVF në përgjithësi ishte e mirë, ku u identifikuan vetëm një numër gabimesh jo materiale dhe të gjitha kërkesat e raportimit ishin plotësuar. Obligimet e tjera të raportimit të jashtëm që nuk kanë lidhje me PVF ishin përmbushur plotësisht.

### 2.1 Opinioni i Auditimit

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Si *Theksim i çështjes* ne dëshirojm të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se shpalesjet e pasurive fikse nuk janë plotësisht të besueshme. Kjo nuk ka ndikim në ndonjërin prej dy Pasqyrave Financiare ("Pranimet dhe Pagesat në Para të Gatshme" dhe "Krahasimi i Buxhetit me Shumat Aktuale"), në pajtim me SNKSP në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme. (**SNISA 200/1706** **Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes**).

## 2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

### Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, e datës 07/11/2014, është identifikuar një rrezik domethënës në PVF lidhur me plotësinë e pasurive, në lidhje me prezantimin e Nenit 16,- Prezentimi edhe Shpalosja e Pasurive.

### Rreziku i identifikuar

#### Çështja 1 - Mos regjistrimi i të gjitha pasurive në PVF

Pasuritë në pronësi të UP-së me vlerë mbi 1,000€ nuk ishin regjistruar plotësisht në regjistrin kontabël të pasurive, duke rezultuar kështu në gabime materiale në shënimet e PVF. Poashtu për disa prona, ka paqartësi në lidhje me të drejtat e pronësisë midis UP-së dhe Komunës së Prishtinës dhe kjo ndikon që regjistri i pasurive të mos jetë plotësisht i besueshëm.

**Rekomandimi 1** Rektori i UP-së duhet të inicijojë analizimin e arsyeve për përsëritjen e gabimit në paraqitjen e pasurive në PVF dhe dobësitë e Universitetit për të ndërmarrë veprimet e nevojshme për adresimin e gabimeve. Duhet të ndërmerren veprime shtesë nga ana e menaxhmentit për të siguruar që të gjitha pasuritë mbi 1,000€ të regjistrohen në regjistrin kontabël, dhe të prezantohen në PVF të vitit 2015. Ky proces duhet të jetë nën monitorim direkt nga ana e Rektorit.

## 2.3 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim

### Përshkrimi

PVF duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 03/2013 për PVF-të e organizatave buxhetore;
- Pajtueshmërinë me kërkesat e Ligjit Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP) nr. 03/L-048 dhe ndryshim plotësimet e tij; dhe
- Pajtueshmërinë me Rregulloret tjera relevante;

Në kontekst të PVF-ve në kemi identifikuar këto çështje:

- PVF janë dorëzuar me kohë në Ministria e Financave (MeF)/Thesar;
- Shpalosjet e shpenzimeve për mallra dhe shërbime tek shënimi 8 nuk ishin të plota. Ne kemi identifikuar që kjo shpalosje është nën vlerësuar me 166,545€ për shpenzime kapitale ; dhe
- Shpalosjet mbi pasuritë dhe obligimet e pa paguara nuk ishin të plota.

Marrë parasysh atë më lart, Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, me dorëzimin e draft PVF-ve në Qeveri, të cilës i referohemi më lartë, mund të konsiderohet jo plotësisht e saktë. Kjo mund të jetë bazë për Theksim të Çështjes apo Modifikim të Opinionit .

Është kërkesë e Statutit të UP-së, që kjo e fundit, të publikojë raportin vjetor të performancës. Raporti duhet të përmbledhë objektivat e Universitetit në lidhje me veprimtaritë e saj për të cilat është përgjegjëse dhe duhet të vlerësojë nivelin e realizimit të objektivave për atë vit fiskal. Në këtë kontekst ne kemi identifikuar që ky raport nuk është publikuar në vitin paraprak..

**Rekomandimi 2** Prioriteti i lartë – Rektori duhet të sigurojë që procesi i hartimit të PVF-ve të vitit 2015 të adresojë të gjitha kërkesat e pajtueshmërisë. Poashtu duhet të siguroj se pasuria është regjistruar në regjistrat kontabël dhe është shpalosur saktë në PVF. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF nuk duhet të nënshkruhet, përveç nëse në draft PVF janë zbatuar të gjitha kontrollet e nevojshme. Gjithashtu, Rektori i UP-ë duhet të siguroj se raporti vjetor i performancës do përgatitet dhe publikohet.

### 3 Rekomandimet e vitit paraprak

#### Konkluzioni i përgjithshëm

Edhe pse UP i kishte pranuar rekomandimet e vitit të kaluar, dhe kishte përgatitur një plan të veprimit për adresimin e tyre, një numër çështjesh të rëndësishme mbeten ende për t'u adresuar.

#### Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të të vitit 2013 ka rezultuar në 18 rekomandime kryesore. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2014, vetëm 3 rekomandime janë adresuar plotësisht; 4 janë adresuar pjesërisht, dhe njëmbëdhjetë nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

#### Rekomandimi

---

##### Çështja 3 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

**E gjetura** Një numër i pa mjaftueshëm i rekomandimeve të vitit të kaluar janë zbatuar. UP nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të AP.

**Rreziku** Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare kyçe, dhe dështimi i zbatimit të rekomandimeve të AP ka rezultuar në:

- Mos realizim efikas të planit buxhetor;
- Shpenzime jo të rregullta për angazhimet shtesë të stafit akademik dhe administrativ ;
- Mos efikasitet i vazhdueshëm organizativ dhe vlerë e dobët për para në praktikat e prokurimit;
- Klasifikim jo adekuat të shpenzimeve;
- Mungesë të informacioneve të sakta në lidhje me pasuritë dhe obligimet e pa paguara të Universitetit në pasqyrat financiare; dhe
- Përfitim të limituar nga puna e Auditimit të Brendshëm dhe Komiteti i Auditimit.

**Rekomandimi 3** Rektori duhet të sigurojë që një plan i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Rekomandimet që nuk implementohen brenda afateve të pritshme kohore duhet të shqyrtohen formalisht nga Rektori dhe të merren veprime proaktive për ti adresuar arsyet e raportuara për vonesat e implementimit.

## 4 Qeverisja e përgjithshme

### Konkluzioni i përgjithshëm

Qeverisja e fortë kërkon planifikimin efektiv, implementimin dhe monitorimin e aktiviteteve të UP-së. Aspektet kyçe për adresim, që mundësojnë një kornizë të mirëfilltë qeverisëse janë:

- **Vetëvlerësimi**- Universiteti kishte hartuar një raport të vetë vlersimit i cili do të mund të ishte më vetëkritik, si pikënisje dhe do të përcaktonte pikat e nevojshme për përmirësim;
- **Menaxhimi i rrezikut** - Universiteti nuk ka krijuar procedura formale të identifikimit dhe menaxhimit të rreziqeve në nivel të organizatës;
- **Raportimi tek menaxhmenti** - duhet të formalizohet më shumë, përfshirë edhe monitorimin sistematik të aktiviteteve, shpenzimeve, rezultateve; dhe
- **Sistemi i auditimit të brendshëm** - ku kërkohet fuqizim i mëtejshëm i Njësise i Auditimit të Brendshëm (NjAB), implementim i rekomandimeve dhe kontribut më i fuqishëm i Komitetit të Auditimit.

Si të tilla angazhimet e përgjithshme të qeverisjes, kërkojnë përmirësim. Ne kemi identifikuar se ka mangësi në kontrollet e proceseve në shumë fusha të shpenzimeve. Këto duhet të forcohen në mënyrë që të parandalohen pagesat e parregullta dhe humbjet financiare. Fushat kryesore ku kërkohet përmirësim janë planifikimi i projekteve kapitale, pagat e ligjëruesve, menaxhimi i pasurive, borxheve etj.

### 4.1 Qeverisja e mirë

Në kuadër të UP funksionojnë 17 Njësi Akademike/fakultete të cilat kanë një autonomi të kufizuar veprimi. Procesi i shpenzimeve duke filluar prej planifikimit buxhetor e deri te çertifikimi i pagesave kryhen nga Administrata Qendrore (AQ) e UP-së. Në fakultete ka mungesë të stafit administrativ për të qenë komplet funksional në kuptimin e bartjes së plotë të përgjegjësive. Pozitat e stafit nuk janë të definuara qartë dhe nuk kishte ndarje të qartë të përgjegjësive. Psh. zyrtari i logjistikës në fakultetin e mjekësisë, bën edhe pranimin e mallrave, mban pozitën e zyrtarit të pasurisë si dhe atë të zyrtarit të TI. Po ashtu edhe zyrtarja e të hyrave, përllëgarit dhe përgaditë listën e pagave. Raste të ngjajshme ka edhe në fakultete tjera.

#### Çështja 4 - Kontrollat menaxheriale -Prioritet i lartë

- E gjetura** Ndërrimi i shpeshtë i menaxhmentit ka ndikuar që administrimi i aktiviteteve operative dhe financiare, përfshirë procesin e raportimit të përcillet me dobësi të cilat reduktojnë efektivitetin e menaxhimit të përgjithshëm.
- Rreziku** Mungesa e raportimeve të rregullta mbi mbarëvajtjen e operacioneve të përditshme të Universitetit dhe kontrollat e mbrendshme jo efikase kanë shkaktuar dobësi në menaxhimin e aktiviteteve financiare të UP-së.
- Rekomandimi 4** Rektori i UP-së duhet të sigurojë që të vendoset një strukturë e përshtatshme qeverisëse, përmes së cilës do të instalohet një mjedis i qartë i kontrollit dhe mobilizim i menaxhmentit të lartë rreth raportimit dhe monitorimit të strukturuar dhe transparent për financat dhe rezultatet, si bazë për një qasje më aktive të menaxhimit.

## 4.2 Planifikimi dhe realizimi i Buxhetit

### Përshkrimi

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për UP, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>1</sup>	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>29,731,253</b>	<b>34,505,221</b>	<b>29,115,675</b>	<b>26,001,380</b>	<b>25,113,788</b>
Grandi i Qeveris - Buxheti	19,644,053	22,366,399	21,462,383	16,138,418	15,225,694
Të bartura nga viti paraprak <sup>2</sup> -	-	395,960	392,883	484,942	453,478
Të hyrat vetanake <sup>3</sup>	10,087,200	10,087,200	6,354,334	8,893,360	8,951,376
Donacionet e brendshme	-	2,533	-	4,002	9,465
Donacionet e jashtme	-	1,653,128	906,075	480,657	473,774

<sup>1</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

<sup>2</sup> Të hyrat vetanake të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>3</sup> Të hyrat dhe Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 4,773,968€. Kjo ishte rezultat i rritjes së grantit qeveritar për 2,722,346€ me vendim të qeverisë; përfshirjes së donacioneve në vlerë 1,655,661€; dhe bartjes së të hyrave vetanake të vitit 2013 në shumë prej 395,960€.

Në vitin 2014, UP ka përdorur 84% të buxhet final, me një shkallë më e ulët për 4% krahasuar me vitin 2013. Përgjithësisht, niveli i realizimit të buxhetit është jo i kënaqshëm, dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>29,731,253</b>	<b>34,505,221</b>	<b>29,115,674</b>	<b>26,001,380</b>	<b>25,113,788</b>
Pagat dhe Mëditjet	20,115,738	24,046,798	20,895,563	18,888,351	18,281,648
Mallrat dhe Shërbimet	3,830,862	5,577,473	3,940,197	3,203,258	3,593,185
Shërbimet komunale	1,021,191	868,012	821,046	884,842	930,500
Subvencionet dhe Transferet	1,314,000	1,346,078	1,293,337	1,292,455	1,236,970
Investimet Kapitale	3,449,462	2,666,860	2,165,531	1,732,474	1,071,485

Buxheti i pa shpenzuar në fund të vitit 2014 ishte 5,389,547€, prej tyre 749,586€ janë nga donacionet. Pjesa më e madhe e buxhetit është realizuar për paga dhe meditje (72%).

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Rritja e buxhetit për paga dhe mëditje për 3,931,060€ ka ndodhur për shkak të vendimit të Qeverisë për ngritjen e pagave për 25%. Suficiti buxhetor në fund të vitit 2014 nga kjo kategori ishte 3,151,235€. Kjo ka ndodhur pjesërisht për shkak të planifikimit jo të saktë të pagesave të honorareve dhe kompenzimeve mbinormë të stafit akademik dhe pjesërisht për shkak të vendimit të Qeverisë për zvogëlimin e tarifave që paguajnë studentët për shërbime<sup>4</sup>.
- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me atë fillestar ishte zvogluar për 782,602€, ndërsa shkalla e shpenzimeve për këtë kategori ishte vetëm 81% e buxhetit, me një përmirësim nga viti i kaluar për 22%. Megjithatë në disa projekte kanë ndodhur vonesa në realizimin e punimeve dhe është vërejtur tendenca e rritjes së shpenzimeve në fund të vitit.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime përkundër që ishte rritur për 1,746,611€, nuk ka arritur të realizohet më shumë se 71%. Kjo ka ndodhur për shkak të planifikimeve jo të mira të buxhetit. Ndërsa vendimi i Qeverisë për zvogëlim të buxhetit për 15% nuk ka pasur ndikim në aktivitetet e Universitetit, pasi buxheti ishte plotësuar nga burime tjera.

<sup>4</sup> Në buxhetin final nga burimi I të hyrave vetanake figuron shuma 10,087,200€, përderisa UP ka arritur të mbledh vetëm 6,732,033€ si pasojë e zvogëlimit të tarifave.

- UP kishte pranuar grande nga donatorët e jashtëm dhe të mbrendshëm në vlerë 1,655,661€, të cilat ishin alokuar nepër në të gjitha kategoritë e shpenzimeve. Vetëm 55% nga këto mjete ishin shpenzuar ndërkohë që 749,586€ kanë mbetur të pa shfrytëzuar.

## Rekomandimi

---

### Çështja 5 - Realizimi i Buxhetit - Prioritet i lartë

**E gjetura** Në përgjithësi, realizimi i buxhetit ishte në nivelin e ulët . Suficiti prej 3,151,235€ tek pagat, mbi 500,000€ tek investimet kapitale dhe shpenzimi i vetëm 55% të donacioneve janë fushat në të cilat realizimi i buxhetit është i dobët.

**Rreziku** Realizimi i ulët i buxhetit mund të rezultojë me mos arritje të objektivave të organizatës. Mos përdorimi i donacioneve redukton potencialisht donacionet e tjera në ato fusha ku donatorët shohin përdorimin e dobët të fondeve të tyre.

**Rekomandimi 5** Rektori duhet të sigurojë monitorim sistematik të performancës buxhetore në baza mujore, në mënyrë që të identifikohen dhe adresohen barrierat dhe për të planifikuar nivelet e duhura të buxhetit. Nëse supozimet fillestare të buxhetit janë të pasakta kjo duhet të reflektohet në buxhetin final dhe donacionet duhet të jenë pjesë e planifikimeve buxhetore.

## 4.3 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetanake)

### Konkluzionet e Auditimit mbi të Hyrat

UP ka të dizajnuar sistemin e kontroleve të brendshme që kanë të bëjnë me mbledhjen dhe raportimin e të hyrave, përfshirë nxjerrjen e PVF-ve. Si rezultat i funksionimit të mirë të softuerit për të hyrat, menaxhimi i kësaj fushe është përmirësuar dukshëm, duke krijuar harmonizime të rregullta mujore ndërmjet njësisë akademike dhe administratës të UP-së. Një shqetësim i ngritur gjatë fazës së ndërmjetme të auditimit, në lidhje me raportet dhe barazimet e të hyrave të mbledhura nga studentët , ishte adresuar.

### Përshkrimi

UP kishte planifikuar që gjatë vitin 2014 të inkasojë 10,087,200€ të hyra, ndërsa ka inkasuar vetëm 6,732,033€ apo 67%. Kjo ishte si rezultat i vendimit të qeverisë për lirimin e shërbimeve të studentëve për 50%. dhe lirimin e plotë nga pagesat për disa kategori të studentëve. Të hyrat e bartura nga viti i kaluar janë 395,960€. Të hyrat e mbledhura nga UP janë pjesë përbërëse të buxhetit ndërsa pjesa më e madhe për paga.

Testimet tona nuk kanë evidentuar ndonjë mangësi materiale sa i përket menaxhimit të të hyrave.

### **Rekomandimet**

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## **4.4 Shpenzimet**

### **4.4.1 Prokurimi**

#### **Përshkrimi**

Rregullat e prokurimit kanë për qëllim të sigurojnë që fondet publike të arrijnë vlerën për para përmes aplikimit të një sistemi transparent dhe efikas. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në prokurimin publik. Kjo përfshin kërkesat për të zvogëluar rreziqet në respektimin e afateve në përfundimin e punimeve, shmangies së konfliktit të interesit dhe ofertave të jo të plota dhe arritjen e vlerës për para.

UP bazuar në planin vjetor të prokurimit kishte zhvilluar 83 procedura të prokurimit duke përfshirë investimet kapitale dhe mallrat&shërbimet. Nga këto procedura 19 ishin anuluar për shkaqe të ndryshme.

Shpenzimet vjetore për investime kapitale ishin 2,165,531€, ndërsa shpenzimet për mallra dhe shërbime 3,940,197€, ku pjesa dërmuese i nënshtrohet procedurave të prokurimit.

## Rekomandimi

---

### 1. Çështja - 6 - Dobësi sistematike në prokurim- Prioritet i mesëm

**E gjetura** Nga shqyrtimi i 9 kontratave ne kemi identifikuar disa dobësi të përbashkëta, të cilat kanë pasur ndikim në më shumë se dy kontrata të rishikuara. Në veçanti, kontrollet menaxheriale nuk kanë funksionuar në mënyrë efektive për të parandaluar çështjet e mëposhtme:

*Punet shtesë dhe Aneks Kontrata* - Në dy raste për shkak të planifikimit të dobët të projekteve, ishin kontraktuar punë shtesë me kosto totale 75,927€. Për ndërtimin e amfiteatrit të fakultetit ekonomik në vlerë 38,453€ ishte kontraktuar dhe faturuar më herët por ishte paguar në vitin 2014, dhe rregullimin e fasadës në objektin e Fakultetit Filologjik dhe Fakulteti i Shkencave Matematiko Natyrore (FSHMN) në vlerë 37,473€.

*Pagesa e projekteve të cilat nuk ishin planifikuar* - Mjetet prej 23,095€ të planifikuara për “mjetet e konkretizimit” dhe 21,595€ të planifikuara për mirëmbajtje ishin shfrytëzuar për renovimin e objekteve edhe pse projekti i renovimit nuk ishte i planifikuar sipas PIP-it. Në një rast tjetër, nga mjetet e konkretizimit ishin paguar 162,150€ për furnizimin me pajisje të IT (obligim nga viti i kaluar i cili madje nuk ishte prezantuar në PVF të vitit 2013).

*Klasifikim joadekuat i shpenzimeve* - Në shumë raste kishte mos respektim të kodeve ekonomike gjatë blerjeve si psh disa furnizime<sup>5</sup> në vlerë 166,545€ janë paguar nga kategoritë dhe kodet jo adekuate ekonomike.

**Rreziku** Planifikimi jo i saktë i projekteve shkakton kosto shtesë dhe krijon sfida buxhetore për Universitetin. Realizimi i projekteve jashtë planit mund të rrezikojë realizimin e projekteve të planifikuara dhe arritjen e objektivave të përcaktuara. Blerjet nga kategoritë jo të duhura të shpenzimeve shkaktojnë pasqyrim të gabuar të shpenzimeve dhe të pasurive në PVF.

**Rekomandimi 6** Rektori UP-së duhet të siguroj që projektet të realizohen në pajtim me planifikimet paraprake, ose në të kundërtën të bëhen ndryshime formale të planifikimit. Poashtu duhet të ushtrojë më shumë kontrolle për të siguruar që dobësitë të identifikuar më lartë janë adresuar.

---

<sup>5</sup> Aparat fotokopjues për F Ekonomik në vlerë 8,100€, dhe Mikroskop hulumtues për FSHMN në vlerë 39,893€ ishin paguar nga kodi 13480-shërbime kontraktuese tjera. Ndërsa Pajisje te IT-se në vlerë 22,477€ janë paguar nga IK etj.

---

## Çështja - 7 - Dobësi jo-sistematike në prokurim - Prioritet i lartë

**E gjetura** Nga rishikimi i nëntë kontratave kemi gjetur se kontrollet menaxheriale nuk janë zbatuar me konsistencë gjatë prokurimeve dhe kanë rezultuar me dobësi si më poshtë;

*Mos furnizim i artikujve të kontraktuar* - Në kontratën “Furnizimi me tonera për printera, plotera për fotokopje”, kriteri i përzgjedhjes ka qenë çmimi më i ulët i ofertuar. OE fitues kishte ofertuar çmime jo normalisht të ulëta<sup>6</sup> për disa artikuj. Këto çmime ishin përcaktues të fituesit të tenderit, përderisa UP nuk ishte furnizuar fare me këta artikuj (nuk është e qartë nëse këta artikuj kanë qenë të nevojshëm për UP-në).

*Mosrepektim i afatit të liferimit të mallit*- Kontrata për “Furnizimin me reagenca dhe mjete për degën e farmacisë” në vlerë 122,751€ ishte nënshkruar me 2013, dhe plani dinamik parashihte që furnizimi të bëhej brenda 240 ditëve nga nënshkrimi i kontratës. Një pjesë e mallit ishte sjellur në nëntor 2014, pra me vonesë të theksuar. Komisioni i pranimit ka bërë tri raporte ku ceket që reagentat nuk janë liferuar sipas periudhës të paraparë me kontratë.

*Mosplotësim i kritereve të kërkuara* - Në procesin e prokurimit për “Furnizim të sistemit të rrjetit pa tela të sensorëve në lumin Sitnica” kompanitë fituese të Llotit 1 dhe Llotit 2 nuk i kishin plotësuar disa kërkesa administrative si: qarkullimin bankar dhe lista e punëtorëve të kompanisë etj.

**Rreziku** Futja e artikujve të panevojshëm në listën e furnizimeve mund të bëhet me qëllim të favorizimit të ndonjë OE dhe kjo rrit rrezikun e mashtrimit përgjatë procesit të prokurimit. Zgjedhja e OE jo të përgjegjshëm mund të sjell probleme gjatë realizimit të kontratave.

**Rekomandimi 7** Rektori i Duhet të iniciojë një rishikim të detajuar për të gjetur shkaqet pse kontratat nuk janë zbatuar si duhet dhe pse kërkesat e prokurimit nuk janë zbatuar plotësisht, si dhe të ushtrojë kontrolle të përforcuara për të siguruar që dobësitë e identifikuar të mos përsëriten në të ardhmen.

---

<sup>6</sup> Disa nga Llojët e tonerave që janë ofertuar nga OE fitues me çmime dukshëm të ulëta janë: HP 645, C9730A black, C9731A cyan, dhe C9733A magneta vetëm nga-1€/copë.

---

## 4.4.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

### Përshkrim

Këtu përfshihen të gjitha shpenzimet nga mallra dhe shërbimet që nuk i nënshtrohen procedurave të prokurimit, dhe shpenzimet komunale. Gjatë testimeve tona bërë kësaj kategorie të shpenzimeve kemi vërejtur se akoma ka vend për përmirësim në disa aspekte.

### Rekomandimi

---

#### Çështja 8 - shpenzimet e telefonisë mobile - Prioriteti i mesëm

- E gjetura** Mënyra aktuale e blerjes së shërbimeve të telefonisë mobile (përmes kartelave mbushëse) nuk ofron çmime të favorshme për UP-në. Në bazë të vendimit të këshillit drejtues janë caktuar limitet për këto shpenzime varësisht nga pozitat e zyrtarëve. Poashtu nuk ka ndonjë kontratë të nënshkruar ndërmjet UP-së dhe operatorit ekonomik "Vala" për shërbimet në fjalë.
- Rreziku** Furnizimi me kartela mbushëse rrit rrezikun që pagesat për të njëjtin shërbim të jenë më të larta se sa kontraktimi i këtij shërbimi përmes tenderit të hapur, marrë parasysh ofertat që aktualisht i ofron tregu.
- Rekomandimi 8** Rektori duhet të konsiderojë mundësinë e kontraktimit të shërbimeve të telefonisë mobile nepërmjet tenderit të hapur. Kjo do të siguronte çmime më të volitshme dhe do të ulte koston e shërbimeve. Përveq kësaj tarifat e lejuara duhet të rishikohen për tu përafuar me nevojat reale.

### 4.4.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

#### Konkluzioni i Përgjithshem

Kontrollet që operojnë në kuadër të UP-së në lidhje me sistemin e administrimit të pagave janë të shumta. Me qëllim të rregullimit të këtyre kontrolleve, është nxjerrur një rregullore e brendshme për të ardhurat personale. Megjithatë ne kemi gjetur se zbatimi i kësaj rregullore nuk ishte konsistent, ngase në shumë raste janë bërë pagesa në kundërshtim me dispozitat e saj. Kontrollet në këtë fushë të shpenzimeve nuk ishin efektive për të siguruar arsyeshmërinë e duhur të pagesave për vijueshmërinë e ligjeratave dhe pagesave të orëve mbi normë. Ndërkohë që janë identifikuar edhe një numër çështjesh të tjera si nënshkrimi kontratave, nostrifikimi i diplomave etj.

#### Përshkrimi

Për paga dhe mëditje gjatë vitit 2014 ishin shpenzuar 20,895,563€. Këto pagesa bëhen përmes sistemit të centralizuar qeveritar (payroll).

Ne kemi testuar procedurat e kompenzimit të punonjësve, rregullsinë e kontratave dhe pagesave, vijueshmërinë e mesimdhënësve në ligjerata, kompenzimin e orëve mbi normë etj. Testimet tona kanë vënë në pah mangësitë e mëposhtme:

#### Rekomandimet

---

#### Çështja -9 - Mungesë e dokumentimit të orëve të mbajtura - Prioritet i lartë

**E gjetura** Për muajin prill të vitit 2014 në 7 nga 36 rastet e testuara, mesimdhënësit nuk e kanë plotësuar normën e orëve obligative për të cilën janë kompensuar. Rregullorja për të ardhurat personale parasheh që pagat duhet të reduktohet pjesërisht kur stafi nuk i plotëson të gjithë obligimet, , 50€ për orë të humbur për profesorë, dhe 25€ për asistent. Profesorët janë kompensuar me paga të plota dhe ndalesa nuk janë aplikuar. Gjithashtu një asistent në F Juridik, dhe një Profesor i rregullt në F e Mjeksisë kishin marrë pagë të plotë njëkohësisht UP nuk ka qenë në gjendje të ofroj asnjë dëshmi që orët janë mbajtura.

*Pagesa për orët e angazhimit në AKM (Avansimi i kualifikimeve të mesimdhënësve)*  
- në një nga 6 rastet e testuara për kompenzimin e të angazhuarve në këtë program, ishte bërë kompenrimi i plotë për ligjeruesin, derisa neve nuk na janë ofruar asnjë dëshmi rreth mbajtjes së orëve.

- Rreziku** Mungesa e dokumentimit të vijueshmërisë së procesit mësimor në fakultete dhe mos aplikimi i sanksioneve, ka ndikim negativ financiar. Kjo dukuri rrit rrezikun e kryerjes së pagesave të parregullta për orë që nuk janë mbajtur dhe ka ndikime negative në cilësinë e shërbimeve.
- Rekomandimi 9** Rektori në bashkëpunim me Dekanët e Fakulteteve duhet të forcojnë sistemin aktual të monitorimit të vijueshmërisë së ligjeratave, të aprovimit të orëve të mbajtura dhe procesin e pagesave, në mënyrë që të shmangen pagesat potencialisht të parregullta dhe kompensimet për shërbimet që nuk janë ofruar. Sanksionet duhet të aplikohen sipas rregulloreve të aplikushme.

#### **Çështja -10 - Kompensimi për orët mbi normë - Prioritet i lartë**

- E gjetura** Sipas rregullores së brendshme, personeli akademik që ka dy marrëdhënie pune brenda apo jashtë Universitetit Publik (Primare apo Sekondare), nuk mund të ketë angazhime mbi normë. Ne kemi gjetur se në 19 raste (në pesë fakultete), kishte angazhime të tilla. Shuma e kompensimit të tyre për orët mbi normë në kundërshtim me këtë rregullore gjatë vitit 2014 ishte 46,568€.
- Rreziku** Kontrollat e dobëta të aplikuara në këtë fushë rrisin rrezikun e ndodhjes së gabimeve në sistemin e administrimit të pagave, sidomos me rastin e angazhimit të stafit akademik me mbi normë. Kjo shkakton shpenzime të paplanifikuara të paarsyeshme dhe ndikon negativisht në kontrollat buxhetore.
- Rekomandimi 10** Rektori i UP-së në bashkëpunim me Dekanët e Fakulteteve duhet të ndërmarrin një rishikim të rasteve të identifikuara, dhe të përcaktojnë masat e nevojshme për evitimin e pagesave që janë në kundërshtim me rregulloret e aplikueshme. Një monitorim i vazhdueshëm për orët mbi-normë, duhet të merret në konsideratë nga Rektori për të siguruar që të gjitha angazhimet dhe kompensimet janë në harmoni me rregullat e përcaktuara për të ardhurat personale.

## Çështja 11 - Angazhim i stafit të pakualifikuar në mësimdhënie - Prioritet i lartë

**E gjetura** Në 15 nga 50 rastet e testuara nuk kishte dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar se stafi akademik i përmbush kriteret e kualifikimit të përcaktuara me Ligjin për arsimin e lartë dhe me Statutin e UP-së.:

Në dy nga 12 rastet e testuara në Fakultetin Ekonomik, kemi hasur diploma të panostrifikuara;

Në një rast në Fakultetin Juridik nuk na është ofruar asnjë dëshmi në lidhje me kualifikimin akademik të një profesori të angazhuar. Në një rast tjetër, profesori në cilësinë e lektorit kishte të përfunduar vetëm fakultetin dhe jo nivelin master siç kërkohet me Statutin e UP-së;

Në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë, një mësimdhënës i angazhuar, në dosje kishte vetëm diplomën e nivelit bachelor, dhe një asistente nuk i kishte regjistruar studimet e doktoratës ashtu siç kërkohet;

Në 10 raste në Fakultetin e Mjekësisë (dega Infermieri), kemi konstatuar angazhim të stafit në mësimdhënie me nivelin bachelor të shkollimit gjatë vitit akademik 2013/2014. Sipas zyrtarëve kompetent kjo ka ndodhur në mungesë të kandidatëve me kualifikim adekuat dhe;

Në Fakultetin e Mjekësisë një ndër kriteret e përcaktuara me ligj për angazhim të stafit akademik është nota mesatare e studimeve bachelor dhe master jo më pak se 8, në secilën prej këtyre studimeve. Në katër raste ky kriter nuk ishte plotësuar.

**Rreziku** Angazhimi i stafit të pa kualifikuar akademik rrit rrezikun e shfrytëzimit të buxhetit me kuadro të pakualifikuara si dhe e rrezikon cilësinë e procesit arsimor në përgjithësi.

**Rekomandimi 11** Rektori duhet të inicijojë një rishikim të përgjithshëm të rasteve të identifikuar për të gjetur arsyet e ndodhjes, dhe gjatë proceseve të rekrutimit të siguroj që stafi akademik i angazhuar të ketë kualifikimin e duhur si dhe dokumentacion valid që verteton nivelin e tyre akademik.

## Çështja 12 – Staf akademik me dy marrëdhënie të rregullta pune-Prioritet i mesëm

### E gjetura

Në dy raste stafi kishte nga dy kontrata të rregullta të punës (të deklaruara si punë primare). Një rast në Fakultetin Juridik ku një asistente kishte marrëdhënie primare të punës me UP-në dhe me një OB tjetër. Në një rast tjetër në fakultetin e Mjekësisë, një i punësuar me pagë primare në UP në cilësinë e “Profesor Emeritus” njëkohësisht ishte i punësuar dhe merrte pagë të plotë edhe në Zyrën e Kryeministrit. I njejtë ka moshën 77 vjeçare, ka përfituar dy paga të rregullta primare nga Buxheti i Kosovës dhe në të dyja rastet i janë paguar kontributet pensionale. Kjo është në kundërshtim me *Ligjin per Fondet pensionale Nr. 04/L-101* si dhe me *UA 02/2013 – mbi akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës* përkatësisht me *Nenin 11/3.5* i cili thekson se asnjë anëtar i stafit akademik mbi moshën 70 vjeçare nuk mund të angazhohet në mësimdhënie, ushtrime apo mentorim në institucionet e arsimit të lartë.

Gjatë testimit të pagesave retroaktive, ne gjithashtu kemi hasur në 8 raste ku janë kompensuar profesorë mbi moshën 70 vjeçare në emër të pagesave të provimeve, mentorimit apo anëtarësisë në komisione të mbrojtjes së diplomave. Shuma e pagesave të testuara përfshinë vlerën prej 7,178€.

Poashtu ne kemi gjetur se tre zyrtarë të UP-së përveq kontratave të rregullta të punës marrin kompensime shtesë edhe nga dy institucione tjera.

### Rreziku

Angazhimi i stafit akademik në mësimdhënie mbi moshën e lejuar rrit rrezikun e angazhimit të personave joadekuat në mësimdhënie. Kjo poashtu mund të shkaktojë pagesa në kundërshtim me rregulloret e aplikueshme dhe me performancë të dobët të personelit akademik. Derisa angazhimi në më shumë se një punë ka ndikim negativ në performancën e stafit.

**Rekomandimi 12** Rektori duhet të rishikoj rastet e identifikuara për të gjetur shkaqet prapa tyre dhe për të përcaktuar veprimet e nevojshme për të adresuar këto çështje në të ardhmen. Angazhimi i stafit duhet të bëhet në përputhje me ligjet e aplikueshme dhe statutin e UP-së.

### Çështja 13 - Tejkalim i limitit të lejuar për mentorim në studimet master – prioritet i mesëm

- E gjetura** Rregullorja mbi studimet master e Fakultetit Ekonomik parasheh që një mësimsdhënës mund të jetë mentor deri në 10 tema të punimit të diplomës në nivelin master brenda të njejtës kohë. Kompensimi është i përcaktuar me rregulloren për paga të UP-së. Ne kemi gjetur 4 raste që kanë tje kaluar numrin e lejuar të mentorimit të temave të diplomës. Numri i temave të caktuara për këta profesor ishte 23, 20, dhe në dy raste nga 13.
- Rreziku** Mosrespektimi i limitit të lejuar të temave për mentorim nga profesorët është në kundërshtim me standardin e përcaktuar me rregullore. Kjo mund të ndikoj negativisht në cilësinë e mentorimit, mund të jetë diskriminues ndaj stafit tjetër akademik, dhe shkakton shpenzime në kundërshtim me rregulloren e aplikueshme.
- Rekomandimi 13** Rektori duhet të siguroj që dekani i Fakultetit Ekonomik të respektoj limitet e përcaktuara me rregullore, në mënyrë që të shmangen pagesat që janë në kundërshtim me to, të rritet konkurenca dhe të shtohet cilësia e mentorimit.

## 4.4.4 Subvencionet dhe Transferuat

### Përshkrimi

Planifikimet buxhetore në kategorinë e Subvencioneve dhe Transfereve për vitin 2014 ishin 1,346,078 € ndërsa ishin shpenzuar 1,293,337€, apo shprehur në përqindje rreth 96% e buxhetit.

Vlera më e madhe e subvencioneve është shpenzuar për bursat e studentëve, ku gjatë testimeve nuk kemi hasur ndonjë parregullsi materiale. Megjithëse kemi vërejtur disa pagesa nga subvencionet për qëllime tjera (shërbime), vlera e të cilave nuk ishte materiale, ne nuk kemi ndonjë çështje specifike për të ngritur sa i përket kësaj fushe të shpenzimeve.

## 4.5 Pasuritë dhe detyrimet

### 4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

#### Përshkrim

Vlera e pasurive në regjistrin kontabël në fund të 2014 ishte 18,606,099€. Krahasuar më vitin paraprak ka një rritje për 1,438,140€. Gjatë vitit UP kishte shpenzuar për “pasuri kapitale” shumën prej 2,165,531€. Informatat në lidhje me pasuritë nuk janë menaxhuar në mënyrën më të mirë ngase regjistri kontabël nuk reflekton gjendjen reale të pasurisë.

#### Rekomandimi

---

#### Çështja 14 - Dobësi në menaxhimin e pasurive - Prioritet i lartë

**E gjetura** UP nuk ka arritur ti regjistrojë pasuritë e përfituara gjatë vitit 2014. Një rast i pasurisë së paregjistruar është edhe “Blerja e librave profesionale” në vlerë prej 1,251,361€. Këto libra janë blerë nga Ministria e Arsimit në bazë të marrëveshjes së mëhershme të mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet MASHT dhe UP, dhe pagesat janë bërë nga investimet kapitale. Pranimi i librave ishte bërë nga një komision i përbërë nga përfaqësues të MASHT dhe të UP-së. Zyrtari i pasurisë nuk kishte arritur të bëjë regjistrimet e duhura, për sasi të pranuar pasi që nuk i ishin ofruar dëshmi mbi pranimin e tyre.

**Rreziku** Kontrolllet aktuale mbi pasuritë duket të jenë jo efektive. Si rezultat i kësaj, UP nuk ka një regjistër të saktë dhe të plotë mbi pasuritë e saj. Së këndejmi, nuk është e mundur të ketë edhe menaxhim të mirë dhe vendimmarrje të duhur për pasuritë në dispozicion.

**Rekomandimi 14** Rektori i UP - duhet të sigurojë se zyrtarët e pasurisë bashkëpunojnë ngushtë me Njësitë Akadematike të Universitetit për të regjistruar në mënyrë sistematike të gjitha pasuritë në pronësi të Universitetit, dhe se një regjistër i azhurnuar i pasurive, do të prezantohet para përpilimit të PVF për vitin 2015. Të bëjnë numërimin dhe të verifikoj ekzistencën fizike të pasurive, dhe mbi bazën e rezultateve të regjistrimit, të bëjnë barazimet e duhura me regjistrat kontabël. Pasuritë e pa regjistruara, të regjistrohen dhe shpalosen në PVF-ë.

## 4.5.2 Trajtimi i borxheve

### Përshkrim

Në PVF ishin prezentuar obligime në vlerë 329,120€, një zvoglim i ndjeshëm në krahasim me vitin paraprak. Megjithatë ne kemi vërejtur jo të gjitha obligimet janë përfshirë në PVF. Poashtu nuk mbahen shënime me rastin e pranimin të faturave dhe si rezultat nuk dihet se kur janë pranuar faturat apo kur është afati për pagesën e tyre.

### Rekomandimi

---

#### Çështja 15- Menaxhimi i detyrimeve - Prioritet i lartë

**E gjetura** Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnizuesve në fund të vitit 2014 nuk ishte e plotë ngase detyrimet ndaj Agjencionit të Akreditimit prej 281,200€ nuk ishin përfshirë në PVF.

Poashtu nuk janë përfshi vlerat e detyrimeve kontingjente, pretendimet e Administratës Tatimore të Kosovës për mospagesën e tatimit në paga për stafin akedamik dhe një obligim i mundshëm që lidhet me projektin për përkthimin e librave i cili është në proces gjyqësor (është bërë një përshkrim verbal për pretendimet e ATK-së por nuk janë paraqitur vlerat).

Kjo pasqyron vetëm një pjesë të sfidës buxhetore që mund të ketë UP ngase kishte edhe pretendime tjera të furnitorëve që kanë gjasa reale të shndërrohen në obligime. Kështu kishte ndodhur edhe gjatë 2014 ku për shkak të vonesës në pagesën e tyre, disa fatura të ndryshme, me vlerë totale 106,873€ ishin realizuar drejtpërdrejt nga Thesari.

**Rreziku** Mos mbajtja e evidencave në lidhje me pranimin e faturave shkakton vështirësi në identifikimin e obligimeve reale dhe shpalosjen e saktë të tyre në PVF. Kjo poashtu ndikon edhe në moskryerjen e obligimeve me kohë ndaj furnitorëve dhe shkakton ekzekutimin e pagesave drejtpërdrejt nga Thesari.

**Rekomandimi 15** Rektori duhet të sigurojë një monitorim sistematik në baza mujore në lidhje me gjendjen e borxheve. Regjistrimi i faturave me rastin e pranimin të tyre duhet të jetë si pikënisje e menaxhimit efektiv të tyre. Sa i përket procesit të pagesave dhe qarkullimit të faturave brenda UP-së, do të duhej të shqyrtohet hartimi i një qarkore të brendshme e cila i përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e stafit përgjatë procesit, konform rregullave financiare në fuqi.

## 4.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

### **Konkluzioni mbi Sistemin e Auditimit të Brendshëm**

Aktiviteti dhe puna e kryer nga NJAB gjatë vitit 2014 nuk ishte e mjaftueshme për ti dhënë siguri menaxhmentit se të gjitha aktivitetet dhe sistemet e kontroleve të brendshme kanë qenë efektive. Kjo për shkak të mos realizimit të planit të auditimit dhe numrit të limituar të stafit auditues në krahasim me kompleksitetin dhe shtrirjen e aktiviteteve që mbulon UP. Përveq kësaj edhe Komiteti i Auditimit (KA) nuk ka dhënë kontribut të mjaftueshëm.

### **Përshkrimi**

Sistemi i auditimit të brendshëm është pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm dhe për shkak të rëndësisë së tij ne e prezantojmë këtu veçmas. Ne e marrim parasysh fushëveprimin e punës së auditimit të brendshëm dhe aktivitetet e KA. Përveq kësaj, ne i shqyrtojmë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti i lartë, si rezultat i punës së kryer nga auditimi i brendshëm dhe komiteti i auditimit.

UP e ka të themeluar Njësinë e auditimit të brendshëm (NjAB), e cila përbëhet nga udhëheqësi i njësisë dhe një zyrtar i auditimit. Kjo njësi kishte përgatitur planin vjetor të auditimit për vitin 2014, ku ishin parashikuar 12 auditime, ka përfshirë periudhën aktuale dhe fushat me rrezik. Gjatë vitit ishin finalizuar vetëm gjashtë raporte të auditimit.

## Çështja 16 - Sistemi i Auditimit të brendshëm - prioriteti i lartë

- E gjetura** Vetëm 50% e planit të auditimit ishte kompletuar dhe nuk janë shqyrtuar të gjitha fushat me rrezik domethënës, për këtë arsye ne nuk kemi mundur të mbështetemi në punën e NjAB-së
- Komiteti i Auditimit, nuk kishte dhënë kontributin e pritur për përmirësimin e sistememeve të kontrolleve të brendshme dhe adresimin e ngritura nga Auditimi i brendshëm. Komiteti kishte mbajtur vetëm dy takime dhe në bazë të procesverbaleve, vërehet që nuk janë trajtuar dobësitë dhe rreziqet e raportuara nga NJAB. Përveq kësaj nuk kishte ofruar ndonjë përkrahje konkrete për NJAB apo menaxhmentin.
- Rreziku** Realizimi jo i plotë i planit të auditimit zvogëlon sigurinë e dhënë ndaj menaxhmentit për funksionimin dhe efektivitetin e sistemeve kyçe financiare si dhe zvogëlon mundësinë që ZAP të marrë siguri nga puna e AB. Mungesa e kontributit të KA mund të rezultojë me mos adresim të rekomandimeve të auditorit të brendshëm, dhe me vazhdimin e praktikave joefektive.
- Rekomandimi 16** Rektori duhet të sigurojë që Sistemi i Auditimit të Brendshëm të funksionalizohet më shumë. Aktivitetet e ardhshme të NjAB duhet të fokusohen drejt zhvillimit dhe zbatimit të planeve të auditimit dhe strategjinë e auditimit të bazuar në rrezik. Përveç kësaj, KA duhet të ri-aktivizohet duke i dhënë mbështetje menaxhmentit dhe NJAB, si dhe rekomandimet e auditimit të brendshëm duhet të adresohen si duhet.

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

### Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit - d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë

një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

*Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit*

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

---

## Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare	Rekomandimi 1 Rektori duhet ti analizoj arsyet edhe për mos shpalosjen e vlerave të sakta të pasurive dhe për dështimin për ta zbatuar këshillën e ZAP për adresimin e këtij keq deklarimi. Në 2014 duhet të implementohen procese të përshtatshme për të siguruar prezantim të drejtë të pasurive në PVF.			Ishte caktuar një komision në lidhje me këtë çështje por nuk ka pasur asnjë rezultat
Pajtueshmëria me kërkesat për raportim në PVF	Rekomandimi 2- Rektori duhet të siguroj se procesi i përgatitjes së PVF 2014 edhe formalisht përfshin rishikimin e draft llogarive nga menaxhmenti, me fokus të veçantë mbi fushat me rrezik të gabimit dhe ose/në fushat ku në vitet paraprake, janë identifikuar gabime.			Pa adresuar
Rekomandimet e vitit paraprak	Rekomandimi 3 Rektori duhet të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë një afat kohor të pranueshëm për adresimin e rekomandimeve të bëra nga ZAP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat të rëndësisë më të madhe. Zbatimi i këtij plani duhet të monitorohet dhe të rishikohet nga Rektori në baza tremujore.		Plani i veprimit i ka paraparë afatet për implementimin e rekomandimeve mirëpo zbatimi i këtij plani nuk ishte monitoruar. Si rezultat shumë nga rekomandimet nuk janë implementuar.	

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Rekomandimi 4 - Rektori duhet të siguroj qe përgatitjes së buxhetit i paraprinë një proces analize gjithëpërfshirëse i cili i pasqyron të gjitha informatat përkatëse, përfshirë rezultatet e viteve paraprake dhe ndryshimet e pritura për vitin e ardhshëm. Një monitorim në baza mujore do të shërbente për identifikim e arsyeve për një realizim të ulët të buxhetit dhe do të krijonte një bazë për veprimet e nevojshme për të rritur nivelin e ekzekutimit të buxhetit.		Pjesërisht i adresuar pasi që raportimet nga njësitë e tjera për disa raportime janë përmirësuar, si planifikimi me kohë i kërkesave buxhetore, por në disa fusha ende ka vend për përmirësim.	
Të hyrat	Rekomandimi-5- Rektori duhet të shikoj të shikoj procesin e konsolidimit dhe të vendos ku janë problemet. Ai duhet poashtu të siguroj funksionimi i softuerit SEMS është i rishikuar për të përcaktuar nëse problemi është tek softueri apo tek aplikimi i tij. Në bazë të rezultateve të këtij rishikim të përcaktohen dhe merren masat adekuate për të eliminuar defektet dhe për të siguruar raportim korrekt te të hyrave dhe harmonizim adekuat të informatave.	Edhe pse në fazën e parë të auditimit ne i kemi vrejtur disa mos barazime gjatë aplikimit të SEMSIT, pas këshillave të dhëna këto mangësi janë eliminuar , harmonizimet janë kryer.		
Prokurimi	Rekomandimi 6 -Rektori duhet të kryejë një rishikim të hollësishëm për të përcaktuar pse implementimi i kërkesave të prokurimit nuk janë përmbushur, dhe të identifikojë masat e duhura që dobësitë e identifikuar janë adresuar në mënyrë efektive. Në veqanti duhet të rishikohen kontratat që nuk po realizohen nga ana e kontraktorëve dhe të konsiderohet veprimet ligjore për realizimin apo ndërprerjen e tyre.			I pa adresuar

Dobësitë jo-sistematike të prokurimit	Rekomandimi 7- Rektori duhet të siguroj një plan veprimi sa më të shpejtë për sa i takon qështjes së ngitur në mënyrë që UP-ja të ndërpresë praktikatat e tilla të shpenzimit të parasë të pambështetura në marrëveshje kontraktuale.			I pa adresuar
Kontratat për shërbime të veqanta	Rekomandimi 8 - Rektori duhet që të rishikoj kontratat për shërbime të veqanta për angazhimin e zyrtarëve administrativ si dhe të siguroj që procesi i rekrutimit të jetë i hapur dhe konkurrues.	I adresuar		
Vijueshmëria jo e plotë e procesit mësimor dhe kompensimi joracional ndaj stafit akademik –	Rekomandimi 9- Rektori duhet të rishikoj dështimet në zingjirin e kontroleve aktuale rreth procesimit të pagesave respektivisht monitorimin e vijueshmërisë së orëve mësimore. Bazuar në këtë të përcaktohen veprimet adekuate që mundësojnë procesimin e pagave në përputhje me evidencat e orëve të mbajtura. Aty ku shfaqen rastet e mosvijueshmërisë së orëve të aplikohen ndalesat në paga konform rregullores së aplikueshme për të ardhura personale.			I pa adresuar
Pagat	Rektori duhet ti rishikoj rastet e identifikuar për të qartësuar arsyet pse punëdhënësi kryesor nuk është deklaruar, dhe të përcaktohen masa adekuate që raste të tilla të mos ndodhin në të ardhmen.			I pa adresuar
Pagesa të pabaza për Komisione të ndryshme dhe punë tjera administrative	Rektori duhet të siguroj që puna jashtë orarit të planifikohet dhe që kompensimet për punë jashtë orarit arsyetohen dhe mbështeten me dokumentacionin e duhur përfshi këtu raportet për punën e kryer dhe aprovimet nga mbikëqyrësit direkt të stafit të angazhuar.			I pa adresuar

<p>Pagesat nga FIM - Pagesa për orët e angazhimit ne AKM</p>	<p>Rektori duhet të siguroj që një MiM është dakorduar bazuar në një analizë të plotë të objektivave dhe procedurave. Rektori duhet të bëj një rishikim të mekanizmave aktual të kontrolleve për të parë dështimet dhe për të përcaktuar veprimet e nevojshme për përmirësimin e këtyre kontrolleve në AKM. Rastet e identifikuara nga auditimi do të duhej të shqyrtohen si çështje urgjente nga ana e menaxhmentit dhe masat administrative janë të nevojshme.</p>		<p>Edhe pse MiM i ka skaduar afati, tani krijimi dhe ndarja e të hyrave nga kjo njësi akademike bëhet me rastin e planifikimit dhe ndarjeve bugjetore</p>	<p>I pa adresuar</p>
<p>Pozitat drejtuese me pagë sekondare</p>	<p>Rektori duhet të rishikoj angazhimet dhe kontratat jovalide bazuar në punën sekondare dhe të ndërmerr masa që këto veprime të mos përsëriten në të ardhmën.</p>	<p>I adresuar</p>		
<p>Kontratat e personelit akademik në kundërshtim me Rregullorën e Brendshme për Paga</p>	<p>Rektori duhet të siguroj që kontratat mbi normë të lidhura me personelin akademik janë të rishikuara për të përcaktuar arsyeshmërinë dhe vlefshmërinë e tyre ligjore. Angazhimi i stafit akademik të bëhet në pajtim me rregulloret e Universitetit dhe pagesa ndaj tyre të bëhet konform kontratës. Aty ku ekzistojnë rastet e dy marrëdhënieve të rregullta pune (primare apo sekondare) të ndalohej mbajtja e orëve mbi normë.</p>			<p>I pa adresuar</p>
<p>Mos raportim i duhur i obligimeve</p>	<p>Rektori duhet të siguroj një rishikim të linjave të llogaridhënies së raportimit të obligimeve nga të gjitha njësitë akademike, dhe të vendos kontrole efektive në mënyrë që niveli i borxhit mos të pengoj efektivitetin e operacioneve në të ardhmen.</p>			<p>I pa adresuar</p>

<p>Detyrimet Kontigjente</p> <p>Mos fokusimi i NJAB në fushat me rrezik</p>	<p>Rekomandimi 17- Rektori duhet të siguroj se procesi i raportimit të detyrimeve kontingjente është adekuat dhe i përmban të gjitha shpalosjet e nevojshme në funksion të plotësisë së informatave mbi PVF. Duhet të aplikohen të gjitha mundësitë ligjore për qartësimin e këtyre detyrimeve dhe në rast se vërtetë janë obligime të UP-së atëherë duhet të planifikohet kryerja e tyre në kohë reale.</p> <p>Rektori duhet të rishikoj funksionimin të sistemit të auditimit të brendshëm dhe forcimin e marrëdhënieve në mes të NjAB-së, KA dhe Menxhmentit. KA duhet të jetë më aktiv dhe ta ndihmoj NjAB në kryerjen e detyrave dhe Menaxhmentin në adresimin e rekomandimeve dhe përmirësimin e menaxhimit financiar.</p>		<p>Kemi nje perparim megjithëse ende borgji ne fund të vitit ishte mjaft i theksuar.</p>	<p>I pa adresuar</p>
---	--	--	--	----------------------